

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës

Praktika profesionale

P12

ZGJIDHJET

Data 14/10/2023

Pjesa	Maksimumi i dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK- PIKËT E DHËNA
1. Detyra 1	25	
2. Detyra 2	25	
3. Detyra 3	25	
4. Detyra 4	25	
Total	100	

Shënime të rëndësishme:

1. Shkruani me shkronja të lexueshme
2. Mos përdorni laps të thjeshtë ose stilolaps me ngjyrë tjetër përveç të zezë ose të kaltër. (rreptësisht ndalohet përdorimi i ngjyrës së kuqe)
3. Mos përdorni marker për të hijezuar përgjigjet tuaja.

Detyra 1

Në Kompaninë JAJA, drejtori i operacioneve Beni kuptoi se kishte pasur një rritje të produkteve që dështuan kontrollet përfundimtare të cilësisë. Këto kontrolle u kryen në laboratorin e KC (kontrolli i cilësisë), i cili testoi produktet e përfunduara përpara se të dilnin për shitje. Shkalla e dështimit të produktit ishte rritur nga 1% e artikujve dy vjet më parë në 4% tani, dhe kjo nënkuptonte një rritje të qindra artikujve të prodhimit në muaj të cilat nuk u shiteshin klientëve të JAJA. Produktet e dështuara nuk kishin asnjë vlerë për kompaninë pasi kostot e ripunimit nuk ishin ekonomike. Për shkak se rritja ishte graduale, iu desh një kohë më e gjatë që Beni të kuptojë se shkalla e dështimit ishte rritur.

Një rishikim i plotë i operacionit kryesor të prodhimit nuk zbuloi asgjë që mund të shpjegonte dështimin e rritur dhe kështu vëmendja u përqendrua në laboratorin e KC. Për disa vite, laboratori i KC në JAJA, i menaxhuar nga Jana Koci, ishte marginalizuar në kompani, me personel prej dy personash që punonin në një laborator të largët, larg nga punonjësit e tjerë. Drejtori i operacioneve Beni, i cili projektoi sistemet e kontrollit të brendshëm në JAJA, rrallë vizitonte laboratorin e KC për shkak të vendndodhjes së tij të largët. Ai kurrë nuk kërkoi që informacioni mbi normat e dështimit të produktit t'i raportohet dhe nuk e kuptonte shkencën e përfshirë në procesin e KC. Ai u mbështet në personelin e KC, Janen dhe ndihmësin e saj Artanin, që të dy kishin kualifikime përkatëse shkencore.

Të dy personelët e KC e konsideruan veten të paguar pak. Ndërsa në teori i raportuan Benit, në praktikë, ata e kryen punën e tyre me pak kontakt me kolegët. Puna ishte rutinë dhe përfshinte testimin e produkteve kundrejt një sërë standardesh të pajtueshmërisë. Kërkohej vetëm një nënshkrim në një raport të pajtueshmërisë së produktit që ai produkt të kalonte ose të dështonte në KC dhe këto raporte arkivoheshin më pas dhe askush tjetër nuk i shihte ato.

Në fund u vërtetua se Jana kishte gjetur një blerës vendas për ta paguar drejtpërdrejt atë për produktet e JAJA që dështonin në testet e KC. Shkalla e rritur e dështimit kishte rezultuar nga nënshkrimi i produkteve të saj si 'kanë dështuar KC' kur, në fakt, ato kishin kaluar. Ajo i mbajti të ardhurat nga shitjet për veten e saj dhe gjithashtu pagoi asistentin e saj, Artanin, një pjesë të të ardhurave nga shitja e produkteve të dështuara.

Kërkohej:

- (a) Shpjegoni arsyet tipike pse një sistem i kontrollit të brendshëm mund të jetë joefektiv. (5 pikë)
- (b) Shpjegoni mangësitë e kontrollit të brendshëm që çuan në rritjen e dështimeve të produkteve në JAJA. (10 pikë)
- (c) Diskutoni mbi cilësitë e përgjithshme të informacionit të dobishëm, duke deklaruar qartë se si do të përfitonte Beni nga këto informacione, dhe rekomandoni masa specifike që do të përmirësonin rrjedhën e informacionit nga laboratori i KC tek Beni. (10 pikë)

(Total=25 pikë)

Zgjidhja

(a) Kontrollat e brendshme joefektive.

Sistemet e KB të dizajnuara mirë mund të jenë joefektive për një numër arsyesh.

Kostot më të mëdha se përfitimet. Kjo është kur një sistem KB siguron vlerë të dobët për para ose ofron më shumë siguri sesa nevojitet (d.m.th. kontrolli është tepër i specifikuar). Në një situatë të tillë, kontrolli nuk do të mbështetet ose nuk besohet nga ata që punojnë krahas ose brenda kontrollit, dhe kjo do të zvogëlojë efektivitetin e tij.

Dështimet në gjykimin njerëzor kur vlerësohet një kontroll, ose mashtrim në matjen ose raportimin e një kontrolli. Kur një kontroll mbështetet në matjen njerëzore, gjithmonë ekziston mundësia e gabimit ose përmes mungesës së trajnimit, pa aftësisë, neglizhencës së qëllimshme ose duke pasur një interes të plotë në dështimin e kontrollit (të tilla si me Jana, e cila besonte se ajo mund të fitonte financiarisht nga një produkt që nuk kalonte me sukses përmes një standardi të kontrollit të cilësisë).

Marrëveshjet e fshehta midis punonjësve, mbase me një interes të caktuar në keq-zbatimin ose shmangien e një kontrolli. Ky rrezik është më i madh kur dy ose më shumë njerëz besojnë se mund të fitojnë prej tij. Mund të jetë, për shembull, një ekip shitjes që citon gabimisht shifrat e shitjeve kundrejt një buxheti ose drejtorët raportojnë keq të dhënat e kontabilitetit për të rritur shpërblimet e tyre ose për të mbajtur një çmim më të lartë të aksioneve para se të ushtrojnë opsionet e aksioneve. Bashkëpunimi midis Jana dhe Artanit (i cili mori një pjesë të pagesës) ishte një nga faktorët që mund të ketë çuar në dështimin e kontrolleve të KC.

Ngjarjet jo-rutinë ose të paparashikuara mund t'i bëjnë kontrollet joefektive nëse ato synojnë të monitorojnë vetëm një proces specifik. Shumica e kontrolleve të brendshme nuk janë në gjendje të përballen me ngjarje të jashtëzakonshme dhe prandaj duhet të përshtaten ose anashkalohen kur ndodhin ngjarje të tilla.

Kontrollet e mëparshme ose ato ekzistuese **mund të vjetrohen** sepse ato nuk azhurnohen për të përmbushur kushtet e ndryshuara. Një kontroll i dizajnuar për të monitoruar një proces ose rrezik që ka ndryshuar, zvogëluar ose ndërprerë nuk do të jetë më efektiv. Ndryshimet në rreziqet kryesore, për shembull, duhet të modifikohen nëse ato vazhdojnë të mbesin efektive në kontrollin e rrezikut.

(b) Mangësitë e KB në Yaya.

Jana ka mashtruar me raportet e pajtueshmërisë pasi ç ato nuk kërkohej ti nënshkruante askush përveç saj.

Sistemi nuk kërkonte një nënshkrim të dytë dhe askush nuk i pa raportet e pajtueshmërisë së produktit pas përfundimit, kështu që Jana nuk kishte askënd për të rishikuar, konfirmuar dhe siguruar që matjet e saj të KC ishin të vërteta ose të sakta. Ajo besonte se ishte paguar dobët dhe kjo mund të ketë rritur stimuljt për të kryer mashtrimin. Për më tepër, duket se ajo u la të 'shkatërronte' mallrat që dështuan KC, duke e lejuar atë të shiste mallrat jashtë. Ndarja e përgjegjësisë së asgjësimit të mallrave nga përgjegjësia e krijimit të raporteve gjithashtu do të kishte ndihmuar në parandalimin e kësaj mashtrimi.

Lidhur me këtë, kishte një marrëveshje të fshehtë midis Jana dhe Artanit, i cili mori një pjesë të të ardhurave për bashkëpunimin e tij në mashtrim. Kjo do të thoshte që të dy personat në departamentin e KC ishin të përfshirë si dhe izolimi i laboratorit e bëri zbulimin e aktiviteteve të tyre më pak të mundshëm.

Nuk kishte asnjë kontroll të aftë për të sinjalizuar automatikisht menaxhmentin se shkalla e dështimit ishte rritur. Fakti që norma u rrit gradualisht dhe jo në një ndryshim të pjerrët duket se e ka bërë

ndryshimin më pak të dukshëm, por një shkallë maksimale e pranueshme dështimi me një sistem të përshtatshëm matjeje do të kishte shkaktuar një sinjal për menaxhmentin që norma ishte rritur mbi të.

Mënyra se si departamenti i KC u pa nga kompania nënkuptonte që aktivitetet e saj do të kishin marrë më pak vëzhgim sesa pjesët e tjera të biznesit. Departamenti i KC ishte i marginalizuar dhe ishte vendosur larg aktiviteteve të tjera dhe kombinimi i këtyre faktorëve e bëri të pamundur që ata shpesh të shqetësoheshin. Fakti që nuk kishte asnjë lidhje automatike raportimi midis KC dhe Benit ishte mbase simptomatike e marginalizimit dhe kjo kontribuoi në problem.

Drejtori i operacioneve Beni ishte neglizhent si menaxher dhe kishte pak kontroll mbi procesin. Ai rrallë vizitoi laboratorin e KC, dështoi të monitorojë shkallën e dështimit të produktit dhe nuk arriti të dallonte një rritje katërfish të normave të dështimit të produktit. Ishte ai që projektoi sistemin dhe me një numër kaq të madh dobësish në sistem, ai duhet të mbajë një pjesë të përgjegjësisë për mungesën e kontrollit, nëse jo për vetë mashtrimin aktual.

(c) Cilësitë e përgjithshme të masave specifike të informacionit.

Cilësitë e informacionit të dobishëm për z. Janoon

Informacioni i dobishëm ka një numër cilësish të përgjithshme që e dallojnë atë nga informacioni më pak se i dobishëm. Ky është një element shumë i rëndësishëm i një sistemi të kontrollit të brendshëm, siç dëshmohet nga mungesa e rrjedhës së informacionit të Beni në kompaninë JAJA.

Informacioni që rrjedh tek Beni duhet të jetë relevant, i besueshëm, me kohë, i kuptueshëm dhe me kosto-përfitim. **Relevant** do të thotë që gjithçka që Jana mendon se duhet të silllet në vëmendjen e Benit duhet të përfshihet në informacion. Çdo ndryshim në cilësinë e përgjithshme të mallrave të gatshme duhet të raportohet vullnetarisht, për shembull, çdo çështje që do të parandalonte laboratorin e KC të kryente funksionin e tij të rëndësishëm ose çfardo ndryshimi në normat e dështimit të produktit.

I besueshëm i referohet besueshmërisë së informacionit dhe nëse është apo jo një përfaqësim besnik i asaj që po përcillet. Ka të bëjë me supozimin se është informacioni i 'vështirë', se është i plotë, i saktë, dhe se është i paanshëm, Beni duhet të dijë se informacioni që merr nga Jana është një reflektim i vërtetë i asaj që është në të vërtetë rasti në laboratorin e KC dhe se, për shembull, nivelet e raportuara të dështimit nuk janë nënvlerësuar për përfitimet e saj personale.

Në kohë i referohet faktit se informacioni ka një vlerë kohore. Informacioni që është i vonuar, për shembull, mund të jetë plotësisht i padobishëm për marrësin. Informacioni duhet të mbërrijë në mënyrë që të mund të përpunohet në mënyrë efektive nga marrësi dhe të përdoret për vendimmarrje ashtu siç ishte menduar.

Beni nuk e kupton shkencën që qëndron pas proceseve të KC dhe për këtë arsye është e rëndësishme që çdo informacion nga laboratorin e KC të jetë i kuptueshëm prej tij. Meqenëse Jana dhe Artani kishin kualifikime përkatëse shkencore, ishte e rëndësishme që informacioni i dhënë për Benin të ishte pa zhargon dhe në një formë që është domethënëse për të si një jo-shkencëtar.

Kost-benefit do të thotë që kostoja e ndodhur për të gjeneruar informacionin nuk tejkalon përfitimin e saj. Raportet e thjeshta mbi pajtueshmërinë e KC të JAJA mund të jenë me kosto të dobishme, për shembull, por në situata të tjera, raportet speciale mund të jenë të kushtueshme për t'u prodhuar dhe të kenë pak pasoja për përdoruesit përfundimtarë.

Masat specifike të rrjedhës së informacionit

Beni mund të merrte raporte më të shpeshta, mbase javore ose mujore, mbi normat e dështimit të KC. Fakti që kaluan dy vjet pa e vërejtur dështimin e shtuar tregoi se ai nuk kishte rrjedhë efektive të informacionit mbi problemin. Një rrjedhë e besueshme e metrikave kryesore të KC do t'i mundësonte atij të përfizonte këto metrika me kalimin e kohës, duke theksuar kështu çdo ndryshim me kalimin e kohës.

Sigurimi i një formati të paracaktuar që do të plotësohej nga Jana do të siguronte që ai të merrte informacionin e nevojshëm dhe do të vendoste rrjedhën e informacionit në duart e tij sesa me Janen.

Informacioni që ai merr mund të jetë i një cilësie më të lartë, me më shumë detaje mbi pajtueshmërinë e produktit kundrejt metrikave specifike. Të dhënat e detajuara do të kishin zbuluar faktin që Jana kishte dështuar produkte që, sipas specifikimit të produktit, duhet të kishin kaluar, dhe kjo gjithashtu mund të kishte zbuluar mashtrimin më herët.

Kontakt i rregullt fizik rutinor me punonjësit e KC, veçanërisht me menaxherin e KC. Mashtrimi u shkaktua pjesërisht nga mjedisi brenda JAJA që e shihte KC si marginale dhe të papërshtatshme, dhe pjesërisht nga Jana, duke besuar se puna e saj ishte e papërgjegjshme dhe e pa monitoruar. Duke lëvizur laboratorin e KC më pranë operacioneve kryesore ose duke vendosur një regjim më të qartë zyrtar të raportimit nga menaxheri i KC tek drejtori i operacioneve, cilësia e rrjedhës të informacionit do të përmirësohej, dhe mundësia për mashtrim do të zvogëlohej.

Detyra 2

Artur Gërbeshi ka qenë drejtor ekzekutiv i Llamp Holding, një kompani e listuar, për më shumë se 15 vite, gjatë së cilës kohë kompania ka qenë shumë e suksesshme në pëfitimin e një pjese të mirë të tregut dhe arritjen e niveleve të profitabilitetit e cila dukshëm tejkalon konkurrencën. Pjesa më e madhe e këtij suksesi i është atribuar veçanërisht mënyrës se si Artur ka menaxhuar kompaninë. Kështu që kur ai e këshilloi bordin në mbledhjen e tij të fundit që ai planifikonte të dilte në pension në fund të vitit, ekzistoi shqetësimi i vërtetë për emërimin e pasardhësit të tij. Llamp Holdings është veçanërisht e vetëdijshme se çdo pasiguri që mund të lindë gjatë periudhës tranzitore të drejtorit ekzekutiv mund të rezultojë në një rënie të çmimit të aksioneve, të cilën ata qartë dëshirojnë të shmangin.

Politika e shpërblimit në Llamp Holdings përfshin një dispozitë për dhënien e një numri domethënës të opsioneve të aksioneve drejtorëve ekzekutiv kur kompania arrin nivele të larta të performancës. Për shumë vite objektivat e vendosura nga komiteti i shpërblimit janë tejkaluar, kështu që Artur ka grumbulluar një numër të madh opsionesh në aksione të cilat ai mund t'i ushtrojë në çdo kohë gjatë vitit të ardhshëm. Si pjesë e planifikimit të tij të daljes në pension, Artur është këshilluar me një këshilltar të pavarur financiar i cili ka rekomanduar që ai të ushtrojë opsionet e tij të aksioneve para se të dalë në pension sepse ato do të japin një fitim kapital efikas për tatimet të cilin ai më pas mund të investojë për të ardhmen e tij. Është e qartë se do të jetë në interesin më të mirë të Arturit të zgjedh një datë ushtrimi kur çmimi i aksionit tregtohet në nivelin më të lartë. Prandaj, kur u paraqit një kontratë e re nga drejtori i shitjeve, e cila do të rriste qartë çmimin e aksioneve të kompanisë këtë vit, Artur ishte një mbështetës entuziast.

Fatkeqësisht, drejtori i financave e këshilloi bordin që kredia e saj bankare përmban një kusht sipas të cilit i kërkohej kompanisë të mbajë normën e mbulimit të interesit katër herë të fitimit të saj para tatimit. Megjithatë Llamp Holdings ka qenë gjithmonë në gjendje të përmbushë këtë kusht kredie, drejtori i financave është i shqetësuar se investimi i mëtejshëm në kapitalin qarkullues të nevojshëm për kontratën e re të propozuar paraqiste një rrezik të konsiderueshëm të shkeljes së këtij kushti të kredisë.

Për të adresuar këtë çështje, drejtori ekzekutiv sugjeroi që stoqet mund të vlerësohen ndryshe në mënyrë që të raportonte një fitim më të lartë, dhe në këtë mënyrë rritet niveli i mbulimit të interesit. Ai më tej sugjeroi që 'ky ndryshim i vogël i politikës nuk do të kundërshtojë nga aksionarët' pasi padyshim që do të rriste vlerën e çmimit të aksionit. Ai gjithashtu e këshilloi bordin se ishte i sigurt se ai mund të përdorte miqësinë e tij të gjatë me partnerin e angazhimit të auditimit të Llamp Holdings, të cilin e kishte trajnuar si kontabilist shumë vite më parë, për të bindur ekipin e auditimit që të pajtohet me vlerësimin më të lartë të stoqeve gjatë auditimit të ardhshëm.

Kërkohet:

(a) Një rrezik i vetëvetishëm në çdo kompani të listuar është që drejtorët e saj kanë fuqinë të ndjekin interesat e tyre personale, të cilat mund të mos jenë në përputhje me detyrat e tyre të besuara ndaj aksionarëve.

Shpjegoni termin konflikt interesi në këtë kontekst dhe duke përdorur informacionin nga skenari, diskutoni se si Sjellja e Arturit paraqet një konflikt të qartë interesi, duke theksuar se çfarë veprimi duhet të ndërmerret ai. (8 pikë)

(b) Përshkruani marrëdhëniet e agjencisë në Llamp Holdings dhe shpjegoni se si mund të rritë besimin në mes të 'drejtorit' (aksionarëve) dhe agjentit (drejtorëve) llogaridhënia e qartë dhe kështu duke ulur kështu kostot e agjencisë. (9 pikë)

(c) Shpjegoni kuptimin e 'ndershmërisë' kur mbani marrëdhënie biznesi profesionale siç përshkruhet në skenar dhe kritikoni sjelljen etike të Arturit në lidhje me ndershmërinë. (8 pikë)

(Total=25 pikë)

Zgjidhja

(a) Drejtorët e kompanisë kanë një detyrë të besueshme për të vepruar në interesin më të mirë të aksionarëve që i kanë emëruar ata në pozicionin e tyre. Ata veprojnë si agjentë të aksionarëve [kryesuesit], dhe si të tillë u delegohen fuqia dhe autoriteti për të marrë vendime të cilat në fund të fundit do të rrisin vlerën e aksionarëve për një kohë më të gjatë. Një drejtor u detyrohet të gjithë aksionerëve që të mos e vendosin veten në një situatë ku interesi personal bie ndesh me interesat e kompanisë dhe indirekt aksionerëve të saj. Konflikt interesi është kur interesi personal i dikujt është në kundërshtim me detyrën profesionale të kujdesit.

Në kontekstin e qeverisjes së korporatave, drejtorët duhet të shmangin tundimin për t'u ndikuar nga faktorë që mund të mos jenë në interesin më të mirë të kompanisë. Kjo mund të përfshijë:

- pranimi i benefiteve personale në sajë të pozitës së tyre si drejtor, ndoshta në dëm të kompanisë;
- shmangia e ndikimit të palëve të jashtme, të tilla si drejtorët e tërthortë, kur kjo bie në konflikt të drejtpërdrejtë me interesin më të mirë të kompanisë; dhe
- drejtorët që kontraktajnë me kompaninë e tyre, përveç kur lejohet nga statuti dhe kur interesi i drejtorëve shpaloset plotësisht.

Në skenar mund të vërehet qartë se motivimi dhe veprimet e Arturit mbështeten nga pensionimi i tij i afërt. Ai po përdor pozicionin e tij të pushtetit në bordin e kompanisë për të ndikuar në vendimin për të rivlerësuar stoqet dhe në këtë mënyrë të fryj fitimet e raportuara. Kjo nga ana tjetër duhet të ketë efektin e rritjes së çmimit të aksionit të kompanisë dhe vlerës së opsioneve të aksioneve që zotëron Arturi, për të cilat ai është këshilluar të ushtrojë para pensionimit të tij.

Megjithëse rritja e çmimit të aksioneve do të ishte e dobishme për të gjithë aksionarët, është motivimi prapa veprimeve të Arturit i cili krijon konflikt interesi. Ai duket se është i gatshëm të përdorë miqësinë e tij të gjatë me partnerin e angazhimit për auditim për të bërë presion mbi ekipin e auditimit për të pranuar rivlerësimin e stokeve, edhe nëse baza e kontabilitetit për këtë veprim është e dyshimtë.

Kur Arturi ka ushtruar opsionet e tij, ka gjeneruar një fitim kapital duke shitur aksionet dhe më pas duke u pensionuar si drejtor, ai nuk do të ketë më interes në ndonjë dëm si pasojë e veprimit të tij që mund t'i ketë shkaktuar kompanisë. Në veçanti, nëse më pas kërkohet një rregullim i mëtejshëm i cili mund të zvogëlonte fitimet në një nivel që shkel kushtin e mbulimit të interesit të kredisë, duke e vendosur kompaninë në vështirësi financiare.

Si pasojë, Arturi duhet të deklarojë interesin e tij dhe të lërë pjesën tjetër të bordit të marrë çfardo vendimi në lidhje me rivlerësimin e stokeve. Ai do të shmangë konfliktin e interesit, dhe do të shihet se po vepron në interesin më të mirë të aksionarëve të kompanisë.

(b) Drejtorët e kompanisë, të referuar kolektivisht si bord, janë të ngarkuar me administrimin e punëve të kompanisë nga aksionarët e saj. Drejtorët, individualisht dhe kolektivisht, kanë një detyrë sipas qeverisjes së korporatave të sigurojnë lidhshmëri sipërmarrës dhe të drejtojnë kompaninë në të mirë të aksionerëve.

Velloja e themelimit të kompanisë siguron që ajo të jetë një person i veçantë juridik si nga drejtorët ashtu edhe nga aksionarët, duke mbrojtur kështu pasuritë personale të pronarëve dhe investitorëve nga proceset gjyqësore. Kjo ndarje gjithashtu kufizon sa ndikim të drejtpërdrejtë kanë aksionarët mbi drejtorët në kryerjen e përgjegjësisë së tyre. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për një kompani të listuar ku aksionarët thjesht e shohin kompaninë si një mjet investimi, kështu që ata mund të shesin aksionet e tyre në çdo kohë për të ribalancuar portofolin e tyre nëse kërkohet.

Teoria e agjencisë përshkruan marrëdhëniet midis aksionarëve, të njohur si kryesori, dhe drejtorëve, agjentëve të tyre, dhe rrjedh nga koncepti i ndarjes midis pronësisë dhe kontrollit. Në Llama Holding aksionarët punësojnë drejtorët duke përdorur një kontratë shërbimi për të vepruar si agjentë të tyre dhe për të administruar kompaninë në emër të tyre. Agjentëve u jepet autoriteti i shprehur dhe i nënkuptuar për t'u marrë me palët e treta në emër të kryesorit të tyre (aksionarëve) dhe ata mbajnë përgjegjësi nën qeverisjen e korporatave për veprimet dhe rezultatet e tyre.

Në rast se krijohet një situatë, siç përshkruhet në skenar, ku interesat e kryesorit (aksionarëve) dhe agjentëve nuk janë në përputhje domosdoshmërisht, lind një problem agjencie. DE i Llama Holding

duket se është i gatshëm të ndërmarrë rreziqe në emër të aksionerëve, të cilët mund të kenë një qëndrim shumë të ndryshëm ndaj marrjes së rrezikut. Ai ka miratuar një pamje shumë afatshkurtër të performancës së biznesit për t'i shërbyer nevojave të tij në vend që të përqendrohet në maksimizimin e vlerës së aksionarëve për një kohë më të gjatë. Kjo situatë komprometon marrëdhëniet e agjencisë dhe mund të kërkojë një ndërhyrje nga kryesori për të ndërmarrë hapa për të ushtruar një kontroll mbi investimet e tyre, duke rezultuar në kosto të agjencisë.

Kostot e agjencisë mund të përfshijnë:

- kohën dhe shpenzimet e rishikimit të informacionit të publikuar, dhe më pas të marrë pjesë në takime për të monitoruar dhe kontrolluar punën e bordit;
- pagesa për shërbimet e ekspertëve dhe këshilltarëve të pavarur;
- tarifat e auditorit të jashtëm; dhe
- kostot e transaksionit që lidhen me menaxhimin e aksioneve të tyre në kompani.

Këto kosto të agjencisë mund të zvogëlohen kur ndërmerren veprime të drejtpërdrejta për të zgjidhur problemin e përafrimit të interesit, i cili do të përmirësonte përgjegjësinë e bordit. Punësimi i drejtorëve mjaftueshëm të pavarur jo-ekzekutivë për të monitoruar dhe kontrolluar anëtarët ekzekutivë të bordit duhet të ketë një ndikim pozitiv në sjelljen e tyre dhe të frymëzojë besim nga aksionarët.

Në veçanti, një komitet shpërblimi mund të hartojë dhe propozojë pako shpërblimi për drejtorët ekzekutivë të cilat i motivojnë ata të veprojnë në interesin më të mirë të aksionarëve që ata përfaqësojnë.

Lidhja e drejtpërdrejtë midis shpërblimeve dhe performancës i obligon drejtorët për t'u dhënë llogari aksionarëve për veprimet dhe aktivitetet e tyre. Kjo duhet të provojë se ata po kryejnë detyrat e tyre në përputhje me pritjet e aksionarëve për rrezikun dhe shpërblimin. Çdo shkelje e qartë e përgjegjësisë së agjentit mund të rezultojë në sanksionin përfundimtar të largimit të drejtorëve shkelës nga detyra dhe zëvendësimin e tyre.

(c) Ndershmëria do të thotë sinjeritet dhe marrje të vendimeve bazuar në integritet. Ndershmëria është një parim themelor i qeverisjes së korporatës dhe ka të bëjë me thënien e së vërtetës dhe në këtë mënyrë të mos mashtrojë aksionarët ose ndonjë palë tjetër me interes. Për një individ, sugjeron që ata duhet të veprojnë me integritet, duke kryer gjithmonë marrëdhëniet e tyre të biznesit në një mënyrë të ndershme dhe të drejtë.

Arturi nuk është sjellë në mënyrë etike në lidhje me ndershmërinë. Përpjekja e tij për të bindur anëtarët e tjerë të bordit për të rritur vlerën e stoqeve ishte thjesht për përfitime personale; megjithatë ai nuk ua shpjegoi arsyetimin e tij. Në zbatim të agjendës së tij personale ai ka vepruar në mënyrë të pandershme, sigurisht duke mos shfaqur karakteristikat etike të pritura nga një DE (ose ndonjë drejtor). Sugjerimi i tij se ky ishte vetëm një 'ndryshim i vogël i politikës' u krijua për të dhënë një përshtypje të padrejtë të efektit të rivlerësimit tek aksionarët dhe përdoruesit e tjerë të informacionit financiar, duke i mashtruar ata larg nga motivet e tij kryesore.

Graviteti i situatës u shtua nga oferta e DE për të vendosur ndikim të panevojshëm në një miqësi të gjatë me partnerin e angazhimit të auditorëve të kompanisë duke siguruar që ndryshimi i politikës të pranohej si paraqitje e një pamje të vërtetë dhe të drejtë të performancës financiare të kompanisë. Sigurisht, kjo do të nënkuptonte që nëse partneri bindte ekipin e tij të auditimit që të pajtohej me vlerësimin më të lartë të stoqeve në auditimin e ardhshëm, shoku i tij do të bëhej fajtor në këtë shkelje të ndershmërisë.

Më në fund u zbulua se Arturi ka trajnim për auditor shumë vite më parë. Prandaj ai është i lidhur me një kod etike që kërkon që ai të mos veprojë me interes vetjak ose t'i bëjë presion të tjerëve për të vepruar në avantazhin e tij. Veprimet e tij shfaqin sjellje joprofesionale dhe mungesë të thellë të integritetit që mund të rezultojë, nëse provohet, në masa disiplinore dhe sanksione kundër tij.

Detyra 3

Njëri nga kodet kryesore të qeverisjes së korporatës përmban këtë hyrje/shpjegim për komitetin e auditimit.

Bordi duhet të themelojë marreveshje formale dhe transparente për të konsideruar se si zbatohet raportimi i korporatës dhe menaxhimi i rrezikut dhe parimet e kontrollit të brendshëm dhe për ruajtjen e marrëdhënies së përshtatshme me auditorët e jashtëm të kompanisë. Bordi duhet të themelojë një komitet të auditimit në përbërje të së paku 3, ose për kompanitë më të vogëla 2, drejtorëve joekzekutiv. Në kompanitë më të vogëla kryesuesi i bordit të kompanisë mund të jetë anëtarë i komitetit të auditimit, së bashku me anëtarët tjerë joekzekutiv, por jo kryesues i komitetit, me kusht që zgjedhja e tij të jetë e pavarur. Të gjithë anëtarët e komitetit të auditimit duhet të konsiderohen persona të pavarur. Së paku njëri nga anëtarët duhet të ketë përoje relevante financiare.

Kur kompania Asi u listua në bursë, u përpjek të themeloj komitetin e auditimit siç kërkohet me rregulla të bursës. Kompania nuk ishte në gjendje të për zgjedh një drejtor joekzekutiv me përvojë në financa prandaj e caktoi zonjën Sofia, një drejtor joekzekutiv si kryesuese të komitetit. Sofia ishte inxhinierë dhe ishte caktuar një bordin e kompanisë si anëtare për shkak të ekspertizës së saj në teknologjinë të cilën e përdor kompania dhe për shkak se ajo kuptonte modelin e biznesit dhe sistemet e kompanisë. Mirëpo ajo nuk kuptonte çështjet financiare. Sofia i tha kolegëve të saj se nuk kuptonte shumë lidhur me konceptin e pavarësisë. Ajo tha se në fushën të cilës i takon, inxhinieria, kolegët brenda dhe jashtë ndonjë kompanie i ndihmojnë njëri tjetrit dhe kjo shpesh edhe inkurajohej. Si komunitet i specialistëve, ata kanë kuptuar se ndihma ndaj njëri tjetrit ishte pjesë e rëndësishme e jetës profesionale. Prandaj, ajo tha se nuk e kuptonte në të vërtetë pse pavarësia ishte aq e rëndësishme për anëtarët e komitetit të auditimit. Ajo po ashtu tha se nuk kuptonte shumë për marrëdhënien e kompanisë me auditorët e jashtëm.

Kërkohet:

(a) Përkufizoni 'pavarësinë' në kontekstin e komitetit të auditimit dhe shpjegoni pse anëtarët e komitetit të auditimit duhet të konsiderohen të pavarur në momentin e caktimit si anëtar. (8 pikë)

(b) Diskutoni se si kërcënon paaftësia për të caktuar një person me 'përvojë relevante financiare' efektivitetin e komitetit të auditimit në kontributin ndaj vlerës së aksionarëve. (8 pikë)

(c) Shpjegoni natyrën e 'marrëdhënies së përshtatshme në mes të kompanisë me auditorët e jashtëm' dhe diskutoni se si komiteti i auditimit të kompanisë Asi duhet përgjigjet nëse beson se kjo marrëdhënie është shumë e afërt. (9 pikë)

Total 25 pikë

Zgjidhje

(a)

Pavarësia është cilësi që posedohet nga individët dhe i referohet shmangies së influencës nga interesat. Kjo liri mundëson që të merret një pozicion më objektiv lidhur me çështjet. Në rastin e pavarësisë së anëtarëve të komitetit të auditimit, është me rëndësi që anëtarët nuk janë të influencuar nga funksioni financiar i kompanisë ose anëtarët tjerë të bordit. Pavarësia e anëtarëve të komitetit të auditimit mund të kërcënohet përmes familjaritetit të tepruar me drejtorët ekzekutiv. Për këtë arsye shumë kode të qeverisjes kanë masa të vendosura për të parandaluar këtë familjaritet të tepruar. Këto masa përfshijnë kufizime në skemat e opsioneve të aksioneve për drejtorët joekzekutiv, emërimet të kufizuara me kohë (vite) dhe ndalesa për drejtorë në pozita kryqëzore. Kufizime tjera përfshijnë nivele të përcaktuara të pagave, numër i detyruar i viteve pas pensionimit për tu kthyer si drejtor joekzekutiv në kompani dhe të mos ketë marrëdhënie të afërta në mes të drejtorëve ekzekutiv dhe joekzekutiv.

Pavarësia e anëtarëve të komitetit të auditimit

Pavarësia është e dobishme për pikat e fërkimit në menaxhimin e kontrolleve të brendshme dhe rreziqeve. Duke sjellur ‘një palë sy të freskët’ në fushat e rëndësishme të mbikqyrjes nga ana e komitetit të auditimit, komiteti i auditimit mund të veprojë pa paragjykime dhe anshmëri. Me një input të rëndësishëm në raportimin financiar, për shembull, komiteti i auditimit duhet të sigurojë saktësinë e raportimit dhe fuqinë e sistemeve që mbështesin raportimin. Pa ‘bagazhin’ e njohjes së historisë së sistemeve të caktuara, anëtarët e komitetit të auditimit mund të vlerësojnë fuqinë e sistemeve për herë të parë. Anëtarët duhet të jenë të lirë nga interesat personale dhe të veprojnë vetëm në interes të aksionarëve. Anëtarët nuk përfaqësojnë ndonjërin pjesë të kompanisë (psh bordin, sindikatën ose interesa tjera me të cilët mund të kenë simpati) por interesat strategjike të aksionarëve. Komiteti i auditimit duhet të jetë në gjendje të rishikojë, analizojë dhe të veprojë në pajtueshmëri me raportet për kontrollet e brendshme pa frikë se do të shqetësojë shokët ose kolegët brenda kompanisë me të cilët mund të jetë njohur.

Pavarësia e anëtarëve të komitetit të auditimit shërben për të risiguruar investuesit dhe drejtorët tjerë joekzekutiv duke bërë që qeverisja në kompani të duket më e fortë dhe më ebesueshme. Qëllimi kryesor i një komiteti të auditimit është ofrimi i një mbikqyrjeje të pavarur të sistemeve të qeverisjes në një kompani të listuar, prandaj aksionarët dhe palët tjera me interes e vlerësojnë lart një komitet të auditimit. Prandaj është e rëndësishme që ky komitet të jetë i pavarur.

(b) E para, kjo tregon se kompani ka problem me pajtueshmërinë dhe ky nuk është fillim i mirë për një kompani që sapo është listuar në bursë. Një aksionar mund të pyes pse kompania nuk ishte në gjendje të punësonte drejtorë joekzekutiv për të siguruar pajtueshmëri me rregullat e listimit në bursë. Kjo do të ndikojë në mënyrë negative në perceptimin e kompetencës së menaxhmentit të kompanisë dhe kështu edhe në gatishmërinë e tyre të investojnë në këtë kompani dhe ti besonë bordit me vendime strategjike. Disa nga funksionet e komitetit të auditimit kërkojnë një përvojë të caktuar në raportim financiar dhe komiteti nuk mund të operojë ashtu si duhet nëse kjo përvojë mungon. Komiteti duhet të rishikojë pasqyrat financiare vjetore, prandaj kërkohet një njohuri për mënyrën e përpilimit të pasqyrave financiare. Nëse kjo përvojë nuk është e pranishme në komitetin e auditimit, ata nuk do të jenë në gjendje të ofrojnë rishikimin e duhur dhe kjo hap rrugën për

marshtrime të mundshme. Komiteti i auditimit po ashtu ka rol të rëndësishëm në mbikqyrjen e marrëdhënieve në mes të kompanisë dhe auditorëve të jashtëm. Edhe pse Sofia ka një njohuri të mirë për kompaninë, ajo nuk ka njohuri të duhur lidhur me këtë marrëdhënie. Si pjesë kyçe për të ruajtur besimin e aksionarëve në saktësinë e sistemeve të kontabilitetit dhe pasqyrave të audituara, një auditor efektiv dhe i pavaruar është esencial. Nëse Sofia nuk është në gjendje të kontibujë në rolin e saj për shkak të mungesës së njohurisë në financa dhe kontabilitet, besimi i aksionarëve do të zvogëlohet. Komiteti i auditimit po ashtu ka rol në pranimin e raporteve për kontrollet e brendshme dhe të menaxhimit të rrezikut. Ka mundësi që, si inxhinier, Sofia do të jetë mirë e pajisur për të kuptuar këto raporte. Mungesa e ekspertizës financiare të saj do të thotë se ajo nuk është e pajisur me njohuri për të kuptuar sistemet e kontrollit të brendshëm për raportimin financiar.

(c) Natyra e marrëdhënies – Është me rëndësi që marrëdhëniet në mes të komitetit të auditimit dhe auditorit të jashtëm të jetë e përshtatshme pra të mos jetë e afërme dhe të jetë e lirë nga kërcënimet etike ndaj pavarësisë. Kjo do të thotë se auditori nuk duhet të ketë kërcënimet të familjaritetit, itneresit vetiak ose interesave tjera të cilat mund të komprometonin pavarësinë e tij. Komiteti i auditimit, duke vepruar në emër të aksionarëve, duhet të siguroj pavarësinë dhe efektivitetin e auditorit të jashtëm me rolin e tij si komitet duhet ofruar siguri për pasqyrat financiare dhe sistemet të cilat i mbështesin ato. Komiteti i auditimit ka fuqi, sipas rolit që ka, të rekomandojë zëvendësimin e auditorit nëse beson se auditorëve ju mungon pavarësia kundrejt kompanisë. Kjo do të thotë se komiteti i auditimit duhet të adoptojë një pozicion të parazgjedhur të të qenit skeptik ndaj auditorëve të jashtëm në mënyrë që të sigurojë aksionarët për pavarësinë e auditorëve gjatë gjithë kohës.

Përgjigja e komitetit të auditimit ndaj marrëdhënieve të afërta – ka disa përgjigje të mundshme për komitetin e auditimit nëse besohet se ka marrëdhënie të papërshtatshme në mes të kompanisë dhe auditorëve të jashtëm. Nuk është e pazakont për marrëdhëniet njerëzore në mes të punonjësve të kompanisë dhe auditorëve të jashtëm të jenë miqësore, psh me kontabilistët që kanë miqësi të gjatë dhe janë anëtarë të një organizate profesionale. Varësisht nga shtrirja e perceptuar e kërcënimit ndaj pavarësisë, komiteti i auditimit ka disa opsione për të ndjekur. Shumë firma të auditimit, ndoshta për shkak të rregulloreve të imponura, kanë procedura të rrotacionit të stafit të auditimit që kryejnë auditimin në një kompani. Kjo bëhet për të siguruar se partnerët e angazhimit nuk miqësohen për së tepërmi me klientët e auditimit dhe kështu të kërcënojnë pavarësinë e tyre. Mënyra më e thjeshtë për të rifreskuar marrëdhënien dhe të menjanojë kërcënimin e pavarësisë është që komiteti i auditimit të këshillojë bordin është të kontaktojnë me auditorin për të siguruar se procedurat e firmës së auditimit për rrotacion janë efektive ose të kërkojnë që ndonjëri nga partnerët të ndrrohet nëse ka kaluar disa vite si auditor i kompanisë. E dyta, komiteti i auditimit mund të rekomandojë bordin që të vendoset një politikë sipas së cilës kompania do të kërkonte të tenderohej shërbimi i auditimi çdo disa vite për të siguruar se auditorët ndrrohen brenda asaj periudhe. Në rastet ekstreme komiteti i auditimit mund të rekomandojë bordit që të zëvendësohet auditori nëse ka pasur kërcënim serioz të pavarësisë. Kjo zakonisht konsiderohet si opsioni i fundit megjithatë kjo siguron aksionarët se komiteti i auditimit mund të veprojë në emër të tyre për të siguruar auditim financiar efektiv.

Detyra 4

Artani ishte me fat që trashëgoi disa para dhe vendosi t'i investojë ato për afat të gjatë në një ose më shumë investime në mënyrë që ai të ketë të ardhura më të larta pas daljes në pension. Ai nuk ishte një specialist në kontabilitet dhe kishte pak njohuri se si funksionojnë investimet.

Artani hulumtoi një faqe të internetit për investime e cila i sugjeroi atij se kishte nevojë që të jetë i vetëdijshëm për nivelin e rrezikut të një investimi dhe gjithashtu është e nevojshme për të ditur se çfarë do të jetë qëndrimi thelbësor i tij ndaj rrezikut. Kjo do të thotë se ai nevojitet të vendosë se çfarë ishte oreksi i tij ndaj rrezikut dhe pastaj të zgjedhë investimet bazuar në këtë.

Kur Artani hulumtoi listen e aksioneve në gazeta, ai vuri re se ato ishin të ndara në sektorë (p.sh. banka, kompani farmaceutike, miniera, shitje me pakicë). Ai vërejti se disa sektorë sigurojnë kthime më të larta se të tjerat dhe ai donte të dinte se pse ndodhte kjo. Një faqe internet i sugjeroi atij se rreziqet janë të ndryshme për sektorë të ndryshëm dhe kjo shpjegohet pjesërisht me paraqitjen e rreziqeve të ndryshme financiare dhe të biznesit ndaj të cilave janë të ekspozuar sektorë të ndryshëm.

Një faqe interneti deklaroi se në qoftë se një investitorë potencial kërkon të dijë më shumë për ndonjë kompani të caktuar për të bërë një investim të mundshëm tek ajo, raporti më i fundit vjetor i kompanisë është një pikë e mirë për të i'a filluar. Kjo është për shkak se raporti vjetor përmbanë shumë informacione vullnetare krahas ofrimit të pasqyrave financiare. Artani mund të përdorë këtë informacion për kuptuar strategjinë dhe qeverisjen e kompanisë. Faqja e internetit ka sugjeruar se përmbajtja e seksionit të qeverisjes korporative në raportin vjetor do të jetë veçanërisht e dobishme për të ndihmuar atë që të vendosë për të blerë ose jo aksione në atë kompani.

Kërkohet:

- (a) Shpjegoni 'oreksin e rrezikut' dhe 'ndërgjegjësimin e rrezikut', dhe diskutoni se si oreksi i rrezikut i Artanit mund të ndikojë në zgjedhjen e tij për investimet. (8 pikë)
- (b) Shpjegoni rrezikun e biznesit dhe rrezikun financiar dhe diskutoni pse rreziqet mund të ndryshojnë sipas sektorëve sikurse është sygjëruar nga faqja e internetit. (8 pikë)
- (c) Bëni dallimin, me shembuj, në mes të shpalosjes së detyrueshme dhe vullnetare në raportet vjetore, dhe vlerësoni dobinë dhe ndikimin e shpalosjes së qeverisjes korporative tek Artani në zgjedhjen investimeve të tij. (9 pikë)

Total 25 pikë

Zgjidhja

(a) Oreksi i rrezikut

Kjo përshkruan sjelljen e përgjithshme që një entitet (në këtë rast, Artani, një investitor individual) ka ndaj rrezikut. Ajo përshkruan rolin e investitorit në një vazhdimësi të sjelljes së ndërmjet reduktimit të nivelit të rrezikut dhe të kërkuarit e rrezikut. Një person me një oreks të rrezikut të lartë do të jetë në kërkim të rrezikut dhe një person me një oreks të rrezikut të ulët do të jetë përgjithësisht distancues ndaj rrezikut. Supozohet gjerësisht se rreziku më i lartë është i lidhur me fitimet dhe humbjet më të mëdha, ndërsa investime me rrezik të lartë me kalimin e kohës përcillen me kthime më të larta. Investimet me rrezik më të ulët në përgjithësi me kalimin e kohës, tërheqin kthim më të ulët.

Ndërgjegjësimi i rrezikut

Në kontekstin e investimeve të Artanit, ndërgjegjësimi i rrezik përshkruan aftësinë e një investitori për të njohur dhe matur rrezikun e lidhur me një investim të caktuar. Disa investime (p.sh. aksionet në një kompani, obligacionet qeveritare, obligacionet e kompanisë, etj) kanë rrezik më të lartë se të tjerat duke u mbështetur në atë se çfarë janë ato dhe ku ato qëndrojnë në prioritetin e kërkesave në rast të likuidimit. Për investitorët që kërkojnë për të balancuar një portofol të investimeve në përputhje me oreksin e tyre personal të rrezikut, është thelbësore që të jetë në gjendje të dinë nivelin e përgjithshëm të rrezikut të bashkangjitur për secilën prej tyre.

Zgjedhja e investimeve

Nëse Artani është përgjithësisht distancues ndaj rrezikut, ai do të kërkojë investime të cilat kanë nivele të ulëta të rrezikut dhe niveleve të parashikueshme të kthimit. "Çmimi" i kësaj sigurie është zakonisht një kthim më i ulët me kalimin e kohës në krahasim me një investim më të rrezikshëm, por si pjesë e portofolit, investimet me rrezik më të ulët sigurojnë një bazë mbi të cilën është e mundur për tu ndërtuar me aksionet të zgjedhura me rrezik më të lartë. Investimet tipike me rrezik më të ulët janë obligacionet e kompanisë (kreditë afatgjata për një kompani me një normë të caktuar të interesit) ose, duke supozuar të jetë rrezik edhe më i ulët, obligacioneve qeveritare. Këto janë lëshuar kur borxhi kombëtar i një vendi është i financuar nga kreditë individuale me një normë vjetore të caktuar të intersit dhe një numër të caktuar vitesh.

Nëse Artani në përgjithësi është duke kërkuar rrezikun, është e mundshme që ai dëshiron kthim më të lartë dhe është i përgatitur që të përballojë një rrezik më të lartë për të arritur ato. Ai në përputhje me rrethanat do të kërkojë nga investimet të cilat kanë nivel më të lartë të rrezikut dhe nivele më të paqëndrueshme të kthimit.

Këto kanë të ngjarë të jenë aksione në kompani në mjedise komplekse ose më shumë të turbullta, ndoshta më pak të diversifikuara, dhe me një mundësi për humbje të konsiderueshme ose rritje të kapitalit. Kompanitë më të mëdha me interesa të larmishëm dhe një nivel relativisht të parashikueshëm afatgjatë të kthimit janë më pak të ngjarë të jenë një pjesë e rëndësishme e kërkuesit e investimeve me rrezik. Ai ose ajo ka më shumë gjasa që të zgjedhin për kompani më të vogla, që operojnë në tregjet e reja ose në sektorët rritës të cilët mund të sigurojnë një kthim të konsiderueshëm afatgjatë në krahasim me alternativat tjera. Faktorët beta janë një mënyrë për të matur dhe vlerësuar rreziqet financiare ose paqëndrueshmëritë që përballët një kompani individuale në një treg si tërësi. Investitorët kërkues të rrezikut mund të investojnë në kompanitë që kanë faktorë beta më të madh se një.

(b) Rreziqet e biznesit

Këto janë rreziqet të cilat mund të kërcënojnë mbijetesën e biznesit si i tërë dhe ato mund të vijnë nga shumë burime. Në thelb, ato lindin për shkak të modelit të biznesit në bazë të të cilit vepron në një organizatë dhe strategjitë që ndjekë. Disa aktivitete të biznesit, nga natyra e tyre, ndikojnë në rritjen e rreziqeve të caktuara të cilat mund të kërcënojnë biznesin si të tërë. Disa rreziqe të biznesit mund të ndikojë statusin e 'vijimësisë' dhe kërcënojnë mbijetesën e biznesit. Kjo është kur vazhdimësia e një biznesi në formën e tanishme është e pasigurtë për shkak të kërcënimeve të jashtme për biznesin në nivel strategjik apo dështimit të strategjisë së biznesit.

Rreziqet financiare

Këto janë rreziqet që lindin nga mënyra se si një biznes është i strukturuar financiarisht, menaxhimit të kapitalit qarkullues të tij dhe menaxhimit të financimit të borxhit të tij afatshkurtë dhe afatgjatë. Rrjedha e parasë së gatshme mund të ndikohet fuqishëm nga ajo se sa një biznes ka borxh në raport me kapitalin e tij. Gjithashtu, aftësia e një biznesi për të vepruar në baza ditore varet se si biznesi menaxhon kapitalin e tij qarkullues dhe aftësinë e tij për të kontrolluar llogaritë e pagueshme, e arkëtueshme, paranë dhe stoqet. Çdo ndryshim që e bën situatën e rrjedhës së parasë së gatshme të tij më të keqe, të tilla si mbledhja e dobët e të arkëtueshmeve, huamarrjes së tepëruar, rritjen e normave të huamarrjes, etj, mund të paraqesin një rrezik financiar në rritje për biznesin.

Si ndryshojnë rreziqet sipas sektorit

Faqja e internetit ishte e saktë kur tha se rreziqet ndryshojnë sipas sektorit të biznesit. Një bankë, për shembull, mund të jetë veçanërisht e ndjeshme ndaj rrezikut financiar dhe të mjaftueshmërisë së kapitalit, ndërsa një kompani e minierave mund të jetë veçanërisht e ndjeshme ndaj rrezikut të sigurisë dhe shëndetit.

Kjo është për shkak të mjediseve të ndryshme dhe modeleve të biznesit, strategjive dhe strukturave financiare të aprovuar nga kompanitë në industri të ndryshme.

Sektorët ekzistojnë në mjedise të ndryshme. Kjo do të thotë se faktorët e jashtëm që ndikojnë te bizneset dhe sjellin rreziqe janë të ndryshëm. Disa industri, për shembull, janë të vendosura kryesisht në një zonë gjeografike të caktuar, ndërsa të tjerat janë ndërkombëtare duke ndikuar kështu në rritjen e rreziqeve të tilla si rreziku i kursit të këmbimit, etj. Disa ekzistojnë në mjedise relativisht të thjeshta dhe të qëndrueshme ndërsa të tjerat janë në mjedise më të turbullta dhe të ndryshueshme. Kështu, në mjediset më të paqëndrueshme dhe komplekse, ndoshta me nivele më të larta të rregullimit, ndryshimit të modeleve të konsumit dhe të teknologjisë së lartë, kompanitë do të jenë subjekt i rreziqeve më të mëdha se ato në mjedise më të qëndrueshme dhe më të thjeshta. Kompanitë në sektorë të ndryshëm adoptojnë modele të ndryshme të biznesit. Kjo do të thotë se mënyrat e shtimit të vlerës do të ndryshojnë ndjeshëm midis kompanive në sektorë të ndryshëm. Në një industri të shërbimit, për shembull, vlera është shtuar me ofrimin e produkteve të paprekshme, shpesh me ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të një personi. Në një kompani prodhuese, do të ketë rreziqe që lidhen me menaxhimin e stoqeve kurse një industri shërbimi nuk do të jetë ekspozuar ndaj tyre. Në anën tjetër, një kompani në industri të shërbimeve të tilla si kompani e sigurimit ose bankë ka më shumë gjasa të jenë të ekspozuar ndaj rrezikut të mungesës së caktuar të aftësive teknike dhe rrezikut të mashtrimit.

Sektorë të ndryshëm kanë struktura të ndryshme financiare, strategji dhe baza të ndryshme të kostos. Disa kompani, për shkak të veprimtarisë së tyre kryesore, mbështeten kryesisht në financime përmes marrjes së kredive afatshkurta ose afatgjata, ndërsa të tjerat kanë strukturë më të dobët financiare, apo të tjerat kanë struktura edhe më komplekse financiare. Këto struktura financiare japin rritje të kostove të ndryshme të kapitalit dhe dobësi të ndryshme ndaj faktorëve të tillë të jashtëm si presioni monetar. Pra, përderisa një kompani tradicionale e prodhimit mund të ketë shumë pak borxh, një biznes i inxhinierisë civile i cili ndërmerr projekte të mëdha individuale mund të merr sasi të mëdha të borxhit afat-mesëm për të financuar projektin. Kjo do të thotë se rreziqet janë më të mëdha në një biznes të tillë për shkak të strukture financiare kurse rreziqe më

të vogla në shoqëritë tradicionale të financuara kryesisht nga kapitali aksionar apo fitimet e pashpërndara. Bankat mbështeten në një varg të burimeve të financimit dhe të bëhen të ndjeshme ndaj humbjeve kur këto burime bëhen të vështira ose çmimi i marrjes së këtyre fondeve ngrihet për ndonjë arsye. Disa kompani kanë struktura të ndryshme të kostos të cilat i bëjnë ato më të rrezikshme në rrethana të ndryshme ekonomike. Kompanitë me strukturë të lartë operacionale, siç janë ato që kanë kosto shumë të larta fikse në krahasim me kostot variabile, kanë kthime më të paqëndrueshme thjeshtë për shkak të strukturës së bazës të kostove të tyre.

(c) Shpalosjet e detyrueshme dhe vullnetare të informacionit

Raportet vjetore të përmbajnë të dy shpalosjet, të detyrueshme dhe vullnetare. Shpalosjet e detyrueshme janë ato të cilat janë të nevojshme, ose me statut (p.sh. ligji mbi kompanitë), standard i raportimit ose rregull e listimit. Pasqyrat kryesore financiare, me shënimet e tyre shpjeguese, dhe raporti i auditorit i përkasin kësaj kategorie. Këto janë pasqyra e fitimit ose humbjes, pasqyra e pozicionit financiar (bilanci i gjendjes), pasqyra e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme. Disa pjesë të raportit të menaxhmentit janë gjithashtu të detyrueshme të disa juridiksione siç janë shënimet e përbërjes së bordit dhe shpërblimet e drejtorëve. Rregullat e listimit në disa juridiksione janë rritur në lidhje me kërkesat e shpalosjes. Në shumë vende, për shembull, është e nevojshme një sasi të konsiderueshme e shpalosjes së qeverisjes korporative, siç është deklarata "zbato ose shpjego". Prania e deklaratës "zbato ose shpjego" shpesh është e detyrueshme, por përmbajtja përdoret për të përcjellë shkallën e mos-pajtueshmërisë me kodin përkatës të qeverisjes korporative.

Shpalosjet vullnetare janë ato që nuk kërkohen nga ndonjë kërkesë rregullatore, por janë bërë shpesh megjithatë. Disa nga këto janë bërë për shkak të traditës dhe pritjeve të aksionarëve (të tilla si deklarata e kryetarit të bordit) ndërsa të tjerat janë menduar të lidhen me menaxhimin pretendimeve të palëve të lidhura të kompanisë. Disa kompani përfshijnë dhënien e informacioneve shpjeguese për objektivat në mënyrë që aksionarët mund të kuptojnë idetë e Bordit për të ardhmen, duke përfshirë një deklaratë të misionit ose të ngjashme.

Gjithashtu, informacioni social dhe mjedisor shpesh është përfshirë, duke detajuar, për shembull, politikën e kompanisë dhe objektivat në lidhje me një sërë masash sociale dhe mjedisore. Disa shpalosje të rrezikut janë gjithashtu të ofruara vullnetarisht, për shembull, kur një kompani përshtatë një qasje të integruar të raportimit.

Dobia nga shpalosja e qeverisjes korporative

Shpalosja e qeverisjes korporative në raportin vjetor të një kompanie të listuar, shpesh është e kërkuar nga rregullat e listimit edhe pse përmbajtja e asaj që është e nevojshme ndryshon nga juridiksioni. Në shumicën e rasteve, megjithatë, shpalosja e qeverisjes korporative përfshinë informacionin për drejtorët (ekzekutiv dhe jo-ekzekutiv), informacionin mbi strategjitë, raportet e komiteteve të bordit (përfshirë komiteti i shpërblimit), raportimin e rrezikut dhe informacione mbi çdo ngjarje të pazakonta apo të jashtëzakonshme.

Informacioni në lidhje me bordin do t'i mundësojë Artanit për të parë bilancin e bordit të drejtorëve që udhëheqin kompaninë dhe gjithashtu drejtorët jo-ekzekutiv të cilët ndihmojnë dhe mbështesin bordin ekzekutiv. Duke studiuar përvojën e drejtorëve, ai përfundimisht mund të kuptojë se si edhe bordi po të udhëheqë me kompaninë. Nëse bordi në asnjë mënyrë nuk është në përputhje me ligjet dhe rregullat përkatëse të listimit (të themi bilancin në mes të drejtorëve jo-ekzekutiv dhe ekzekutiv), kjo do të nënkuptonte se si edhe pjesët tjera të kompanisë janë duke u menaxhuar.

Raportimi i rrezikut do t'i mundësojë Artanit për të kuptuar numrin e rreziqeve të cilat kompania po përballon dhe politikën e kompanisë për menaxhimin e këtyre rreziqeve. Sepse rreziqet specifike me të cilat përballen kompanitë, ndryshojnë aq shumë nga sektori dhe nga kompania, këto informacione shpjeguese të ofruara mund t'i mundësojnë Artanit të kuptojë llojet e çështjeve që mund të paraqiten dhe që mund të kërcënojnë vlerën e aksioneve të tij në kompani. Raportet e rrezikut janë domosdoshmërisht spekulative dhe jo të plota, megjithatë, dhe rreziqe të tjera mund të materializohen të cilat nuk janë parashikuar nga kompania. Krahasimi i raporteve të rrezikut nga viti në vit dhe krahasimi me ato të kompanive tjera në sektorin e njëjtë mund të sjellin dobi.

Raportet e Bordit do t'i mundësojnë Artanit për të mësuar në lidhje me rolin e drejtorëve jo-ekzekutiv në kompani dhe se si kundërpeshojnë, mbështesin dhe pengojnë bordin ekzekutiv.

Në shumë juridiksione, raporti i qeverisjes korporative përfshinë një raport të komitetit të shpërblimeve. Kjo mundëson që drejtorët jo-ekzekutiv që përbëjnë komitetin të informojnë aksionarët (apo aksionarët potencial të tillë si Artani) në lidhje me politikat që ata aprovojnë për

shpërblimin e drejtorëve ekzekutiv, dhe për të raportuar në detaje historike të asaj se sa është paguar bordi ekzekutiv në vitin financiar të sapo përfunduar. Artani mund të formoj një pamje të tillë nëse ai beson se politikat janë në përputhje me strategjinë e kompanisë dhe se drejtorët janë paguar në mënyrë të drejtë (ose mbipaguar) për performancën e tyre.

Deklarata e pajtueshmërisë, shpesh referuar si deklarata "zbato ose shpjego" në një juridiksion të bazuar mbi parimet, do t'i tregoj Artanit shkallën në të cilën kompania është në përputhje me dispozitat e kodit përkatës të qeverisjes korporative. Nëse nuk është në përputhje, kjo deklaratë do ta informojë atë për seriozitetin e çfarëdo shkelje dhe ai gjithashtu mund të gjykojë shpjegimin e dhënë se pse kompania nuk është në përputhje të plotë. Nëse ka shkelje serioze dhe një shpjegim të dobët ose jo bindës të dhënë, Artani duhet të marrë këtë parasysh në konsideratën për të investuar në aksionet e kompanisë.